Në kuadër të shërbimeve të saj, Drejtoria Teknike ka gjashtë departamente: Departamenti i Planifikimit dhe Zhvillimit, Departamenti i Prodhimit, Departamenti i Cilësisë së Ujit (per efekt raportimi), Departamentin e Ujit të pa Faturuar (per efekt raportimi), Departamentin e Furnizimit me Ujë, Departamenti i Kanalizimit dhe Ujërave të Ndotura dhe Divizionin e Auto Parkut.

Drejtorja Teknike gjatë muajve raportues ka arritur të menaxhojë trajtimin, cilësinë e ujit të pijshëm, shpërndarjen, mirëmbajtjen e rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimeve dhe zhvillimin dhe planifikimin në zonën e shërbimit pavarësisht mungesës së burimeve njerëzore, në fillim dhe vazhdim të muajit Tetor, dhe pastaj vërshimet e jashtëzakonshme në muajt Nëntor dhe Dhjetor.

Monitorimi i nivelit të liqeneve të Batllavës, Badovcit, kanalit të Iber Lepencit dhe cilësisë së ujit të pijshëm në të gjitha pikat e prodhimit është tregues i Ndërmarrjes.

Niveli aktual i liqenit të Badovcit është i ulët dhe ka tendencë të ngritet me ngadalte pavarësisht që kemi pjesën e dimrit dhe pranverë që mund të sjell reshje, mungesa e sasisë së ujit në akumulim dhe rritja e kërkesës së madhe për ujë nga ajo zonë, është kërkuar nga ME dhe vazhdojmë të kërkojmë mbështetje nga Bordi i Drejtoreve, Niveli Qendror të na përkrah me zgjidhje alternative për stabilizim të nivelit të liqenit me mbushje me ujë të pa trajtuar nga liqeni i Ujëmanit nëpërmjet kanalit të Iber Lepencit. Drejtoria Teknike ka hartuar projektin për rindërtimin e linjës nga stacioni i pompave në kanalin e Iber Lepencit (Çagllavice) deri në hyrje të liqenit.

Angazhimi i shërbimit të cilësisë dhe prodhimit të ujit mban nën kontroll cilësinë e ujit të pijshëm sipas udhëzimeve dhe normave të OBSH-së.

DT me Departamentet dhe NJOU-të po analizojnë situatën aktuale të humbjeve të ujit të pijshëm dhe zbatimin e planeve të hartuar për marrjen e veprimeve për uljen e humbjeve, formimin e ekipeve profesionale monitoruese në zbatimin e planifikimeve (edhe kundër mungesës së kapaciteteve njerëzore ku nevojiten ngritje kapacitetesh burime njerëzore për ngritja e grupeve monitoruese), rritjen e kontrollit mbi përdorimin e paautorizuar të ujit të pijshëm, mirëmbajtjen dhe riparimin e rrjedhjeve në kohe sa më të shpejt duke aplikuar rregulloret aktuale të cilat do të ndikojnë ndjeshëm në arritjen dhe zbatimin e planifikimit.

Krahas inspektimit për të reduktuar humbjet e ujit, kërkohen investime në ndërrimin e rrjeteve të ujit dhe instalim – ndërrim të ujëmatësve në zonën e shërbimit.

KRU “Prishtina” sh.a., ka marrë aprovimin nga KfW në emër të Qeverisë Gjermane dhe BE-së për dhënien e grantit në vlerë prej 61.9 mil. euro, për Projektin “Rrjeti i Kanalizimit dhe Ujërave Atmosferike në Prishtinë”. Gjithashtu në kuadër të këtij Projekti KRUP do të përfitojë asistencë me investime në trajtim - reduktim të humbjeve të ujit dhe ngritje kapacitetesh.

Progresi në Projektin e Impiantit të Trajtimit të Ujërave të Zeza (ITUN), është nënshkruar kontrata për konsulentë, faza e parë e projektit është Studimi i Fizibilitetit ITUN, e cila është në nivel drafti, hartimi i projektit dhe dokumenteve të tenderit, ndërsa faza e dytë e projektit është ndërtimi i ITUN dhe mbikëqyrje.

Me rritjen e kapaciteteve njerëzore do të arrijmë caqet e planifikuara në Planin e Biznesit, objektivat dhe rritjen e performancës.

Planifikimet dhe sugjerimet në Drejtorin Teknikë

Në kuadër të DPZH (Departamentit të Planifikimit dhe Zhvillimit), planifikimet rrjedhin më shumë nga plani i biznesit dhe si tillë është në implementim e sipër, aktivitete tjera planifikuese shtrihen edhe në bashkëpunimet me Komuna dhe donatorë, ku DPZH harton projektet zbatuese për implementim për Ministri, Komuna dhe Donatorë, sigurisht prioritet i kushtohet aktiviteteve në kuadër të departamentit, mbikëqyrjen, e projekteve dhe hartimin e specifikave teknike.

Departamenti i Prodhimit – Trajtimit, planifikon që të mbajë nivelin e trajtimit të ujit, duke pasur kujdes të veçantë në shfrytëzimin e burimeve të ujit, sidomos Badovci dhe pusët nëntokësore, duke pasqyruar parasysh thatësinë që mbizotëron çdo vit. Misioni i departamentit është plotësimi i kërkesave për ujë për të gjithë konsumatorët, mirëpo infrastruktura e cunuar dhe e amortizuar në shpërndarje shpesh herë paraqet problemet e veta. Ajo çfarë është e rëndësishme është urgjenca e gjetjes së fondeve dhe vendosja e prioritetit të çështjes së ndërrimit të linjës Albanik (Shajkoc) Prishtinë, sepse linja është e amortizuar skajshëm.

Departamenti për Cilësi të Ujit dhe Burime, do të vazhdojë me planifikimet për mostrime dhe monitorim të rregullt të cilësisë së ujit të pijshëm, në bashkëpunim edhe me pjesën e njësisë për mbrojtje të burimeve ujore. Në fillim vit janë vendosur shenjat paralajmëruese për zonat mbrojtëse, anë për fat të keq kishte vandalizma që dëmtuan. Departamenti për cilësinë e ujit kërkon që të transferohet në objektin e ITU në Shkabaj, aty ku edhe infrastruktura është më e mirë dhe janë pajisje shtesë që planifikohen të futen në punë.

Departamenti për reduktim të humbjeve të ujit, gjatë këtij tre muaji shtim të aktiviteteve, përqendrim më shumë në inspektim dhe kontrolle, aksione në terren me ekipe shtesë për identifikimin e kyçjeve ilegale dhe monitorimin e DMA ekzistuese, shkyçje, pagesa. Harmonizimin e kërkesave me DPZH për planifikimin e DMA Zonave, inspektime me lexues. Gjatë pjesës vijuese pritet të vazhdojmë me aksionet në terren me identifikimin e kyçjeve ilegale dhe keqpërdorimeve.

Departamenti i Mirëmbajtjes së ujit, planifikon të vazhdojë me mirëmbajtje rutine, për fat të keq ende reaktive, anë për planifikimet janë që të lëvizet në mirëmbajtje proaktive. Planifikohet që të gjitha sanimet dhe rastet e lajmëruara të sanohen brenda ditës, duke i kushtuar rëndësi shfrytëzimit të materialeve, porosisë me kohë në procedura të prokurimit, po ashtu planifikohet që të shtohet numri i ndërrimit të ujëmatësve si pikë kyçe për reduktimin e humbjeve të ujit.

Departamenti për operim dhe mirëmbajtjen e sistemeve të kanalizimeve, do të vazhdojë me mirëmbajtje rutine, duke përfshirë pastrimet e pusëve, asistencë nëpër Njësi Operative, identifikimi i problemeve në rrjet, operimin me ITUN, asistencë konsulencës Gjermane për hartimin dhe finalizimin e fizibilitetit dhe master planit.

Sfidat për të arritur planifikimet

Në drejtorinë teknike siç është cekur edhe më lartë mungesa e stafit dhe mosha e shtyrë e tyre paraqet problem të madh, pastaj mungesa e auto mekanizmit, amortizimi i skajshëm i mekanizmit ekzistues, mungesa e stafit profesional sidomos në departamentin për reduktim të humbjeve është sfida më e madhe sa i përket resurseve njerëzore, angazhimi nuk do të mungojë me resurset ekzistuese që të arrihen të paktën caqet kryesore të planifikuara, por sfida mbeten humbjet, aty ku ka nevojë të rritet numri i inspektorëve. Ndërlidhja me drejtori komerciale pa shmangshëm shkakton probleme, mirëpo e njëjta ankohet për mungesa stafi po ashtu. Rritja e çmimeve në tregun global ka ndikuar shumë në rritje të çmimeve të pjesëve rezervë, fazoneri, tubacione, por ka ndikuar jashtëzakonisht shumë edhe në rritje të kemikateve bazë për trajtim të ujit.

4.1 Departamenti i Prodhimit

Në Departamentin e Prodhimit kemi vazhduar me realizimin e planifikimit të prodhimit për tremujorin Tetor -Dhjetor 2022. Prodhimi TRE MUJOR është afërsisht me planifikimin mujor. Uji primar në Liqejt akumulues ka arrit të ket një kualitet më të mirë ashtu që kemi mundësi që të punojmë me kapacitete optimale. Në FPU Shkabaj FPU Albanik dhe FPU Badovc kemi pasur një prodhim optimal, pavarësisht sfidave me turbullire, bazuar në kërkesën ashtu që për TM4 kemi të prodhuara 13,846,791 m³ ujë të përpunuar dhe të distribuar. Kjo paraqet 102.04 % prodhim krahasuar me planifikimin e tremujorshit TM4.

Edhe nëpër Njësi Operative në Komuna tjera muajin e kaluar kemi një prodhimtari bazuar në kapacitete optimale dhe përshtatur nevojave të kërkesës së prodhimit të ujit të pijes. Zona e furnizimit në Lipjan dhe rrethinë, ka një ndieshmëri të mungesës së ujit pasi që kemi edhe rënjen e nivelit të ujërave nëntoksore si pasojë e thatësirës që po mbizotron kohë të gjatë

Liçeni i Batllavës ka gjendje shumë të mirë hidrike ashtu që javën e fundit të muajit Dhjetor 2022 ka merr pikën maksimale të kapërderdhjes 635 m (max 635 m) mbi nivelin e detit. Ndërsa mbetet shqetësuese situata akumuluese në Liçenin e Badovcit, ku ka pasur një ngritje të ndieshme por ende mbetet larg kuotës maksimale të kapërderdhjes -8.47m (max 649.85 m).

Pas reshjeve të shiut gjatë muajit nëntor por edhe muajit dhjetor 2022 kemi pasur vështërsi në trajtimin e ujit të pijes në ITU SHKABAJ. Pas turbullirës së Liçenit të Pritvoricës dhe ngritje së turbullirës mbi 150 NTU, për orë të tëra në periudhën nga 20.11.2022 e deri në fundin e muajit Nëntor 2022 ITU Shkabaj ka trajtuar minimalisht ujë të pijes si dhe kohë të gjatë ka qenë edhe jashtë mundësive për trajtim.

Gjatë kësaj kohe kemi futë në funksion gypin DN 400 nga rezervari Arbëri në Rezervarin Shkabaj ashtu që të zbusim situatën e furnizimit të Fushë Kosovës me ujë të pijes.

Kemi kaluar në një situat emergjente për furnizim me ujë të pijes për Fushë Kosovën duke furnizuar nga 04:00 deri në ora 10:00, si dhe nga 17:00 deri në 23:00 eventualisht deri në 24:00.

Kjo ka zgjatur për 4 ditët duke filluar nga 20.11.2022, pastaj kemi stabilizuar situatën sa do kudo dhe furnizimi është bërë nga ora 04:00 deri në ora 23:00 eventualisht 24:00 varësisht nga sasia e akumuluar e ujit të pijes.

Kemi një plan për intervenim në gypin DN 400 në zonën e Film City ku ndodhet Qendra Headquarter e KFOR-NATO në Prishtinë. Qasja do të na ipet pasi të kompletojmë dokumentacionin e kërkuar nga KFOR për qasje brenda Kampusit.

Edhe ditët e dhjetor 2022 kanë vazhduar me kujdes të shtuar dhe deri më 23.12.2022 për të pasur një stabilitet gjatë ditës në furnizim me ujë , nga ora 24:00 deri në ora 04:00 kemi ndërprerë furnizimin në

Fushë Kosovë. Nga 23.12.2022 e tutje gjendja është stabilizuar dhe nuk kemi redukime, pra kemi furnizim 24/7 pa ndërprerje.

Muaji	Niveli i Liqenit Batllava 635 max	Niveli i Liqenit Badovci 649.85 max
04.10.2022	631.76 Ose 3 3.24 nën kapërderdhje	640.25 ose 9.60 nën kapërderdhje
27.12.2022	635 niveli në kapërderdhje	641.36 ose 8.49 nën kapërderdhje

Trajtimi për vitin 2022 Janar- Dhjetore:

Viti-muaji	
2022	
Janar	13,784,398m3
Shkurt	TM1
Mars	103.92%
Prill	14,277,450m3
Maj	TM2
Qershor	106,38%
Korrik	14,147,057 m3
Gusht	TM3
Shtator	104.23%
Tetor	13,846,791
Nentor	TM4
Dhjetor	102.04%
Totali	

Aktivitetet apo përshkrimi i punëve të kryera Brenda muajit raportues;

Punët kanë vazhduar me ritmin e zakonshëm sipas planifikimit, qëllimi i trajtimit sa më cilësorë të ujit të pijes ka vazhduar pa ngecje të theksuara, në të gjitha objektet për përpunimin e ujit të pijes.

Specifiko disa nga aktivitetet kryesore;

Si çështje që duhet të theksojmë është se si Ujësjellës duhet të kërkojmë nga Iber Lepenci që të bëhet një zgjidhje adekuate për ditët kur kemi turbiditet të ngritur jashtë çdo mundësie për trajtim.

Të mbrohet kanali nga ujërat sipërfaqësore që shpërlajnë dheun nga arat në pjesët e pambuluara të kanallit

Pkanifikimi për vitin 2023 është përfunduar dhe dërguar në Prokurim për të gjitha kërkesat tona që janë të nevojshme për mbarëvajtjen dhe funksionimin normal dhe optimal të Objekteve trajtuese dhe distribuese.

Pengesat dhe sfidat gjatë punës;

Ballafaqimi me munges ate energjisë elektrike në disa nga objektet prodhuese, arsye punët e planifikuara të KEDS dhe ndërprerje paparalajmrim të energjisë elektrike në raste të mungesës së energjisë elektrike. Përkundër kësaj kohët e fundit nuk kemi ballafaqime të shpeshta me mungesë të energjisë për objektet e KUR Prishtina, sidomos Objektet vitale të prodhimit të ujit të pijes kan pasur furnizim të pandërprerë me energji elektrike. Duhet të përjashtojmë momentet apo ditët kur kemi qenë paraprakisht të njohtuar nga ana e KEDS-it për punime të planifikuara nga ana a tyre.

Punët e planifikuara dhe shkalla e realizimit të tyre;

Prodhimi i planifikuar për muajin Tetor Dhjetor është i arsyeshëm dhe afërsishtë edhe me planifikimin. Arsyetim prodhimi optimal nën kushte të ujit të burimeve pasi që cilesia e ujit primar eshte ne nivel te knaqshem. Është ngritur nje shqetesim rreth saktetise se matjes se ujit te prodhuar ne objekte prodhuese, do te ri tenderohen apo edhe blihen ne tërësi matësit, pasi qe disa here ka dështuar procedura e prokurimit.

Aneks: ndonjë tabelë ose grafikon krahasues me planin ose me periudhën e njejtë të vitit paraprak;

Janar-Dhjetore 2021

Viti-muaji	TOTALI			
2021	TOTALI I UJIT TË DISTRIB. ~m3/muaj~	TOTALI I UJIT TË DISTRIB ~l/s	E PLANIFIKUAR ~m3/muaj~	Përqindja e realizuar
Janar	4,233,040	1,580	4,572,029	92.59%
Shkurt	4,243,653	1,694	4,129,574	102.76%
Mars	4,665,702	1,742	4,572,029	102.05%
Prill	4,621,775	1,783	4,424,544	104.46%
Maj	4,750,870	1,774	4,572,029	103.91%
Qershor	4,690,407	1,810	4,424,544	106.01%
Korrik	4,950,866	1,848	4,572,029	108.29%
Gusht	4,748,343	1,773	4,572,029	103.86%
Shatator	4,575,513	1,765	4,424,544	103.41%
Tetor	4,700,045	1,755	4,572,029	102.80%
Nentor	4,434,521	1,711	4,424,544	100.23%
Dhjetor	4,560,313	1,703	4,572,029	99.74%
Totali	55,175,048	1,745	53,831,952	102.51%

Edhe punët në Shërbimin e makinerisë dhe shërbimin e elektrikës dhe shërbimi për mirmbajtjebn e sistemeve dozuese, kanë vijuar sipas rutinës të planifikuar, punë preventive si dhe duke u përgjigjur në çdo rast emergjent dhe evitim të defekteve.

Punët dhe aktivitetet Tetor-Dhjetor 2022
--

Shërbimi	Numri i intervenimeve	Aktivitete më të rëndësishme mujore
Shërbimi i Makinerisë	78	Mirëmbajtja makinerike e planifikuar, preventive dhe rastet emergjente të paparashikuara
Shërbimi i Elektrikës	115	Mirëmbajtja elektrike e planifikuar, preventive dhe rastet emergjente të paparashikuara
Shërbimi i monitorimit operacional	16	Mirëmbajtja për sistemet dozuese e planifikuar, preventive dhe rastet emergjente të paparashikuara

Lidhur me projektet e parapara në Prokurim kemi dorëzuar projektet e parapara ashtu që si Drejtori e Prodhim lidhur me kërkesat tona qëndrojmë mire dhe në kohë në përmbushjen e kërkesave tona për furnizime dhe për punë ashtu që të kemi një gjendje të mire sa I përkat gatishmërisë teknike dhe teknologjike për të pasur një prodhim të sigurtë.

Edhe për muajt në vijim të vitit 2023 jemi në gatishmëri që të përballemi me sfidat që na paraqiten lidhur me përpunimin e ujit të pijes në Objektet trajtuese, si dhe mirëmbajtjen elektromakinerike dhe të sistemeve dozuese.

4.2 Departamenti i Cilësia e Ujit dhe Burimet

Qëllimi kryesor i Departamentit të Cilësisë dhe Burimeve të Ujit është organizimi dhe funksionimi i tij si Departament për Kontrollen e Cilësisë dhe Burimeve të ujit duke u bazuar në Standardet cilësore, aplikative (U.A.10/2021) dhe ato europiane (Udhëzimi –Direktiva 98/83/EC) mbi kualitetin e ujit për përdorim nga njerëzit (me parë direktiva 80/778/EEC).Kjo direktivë përcakton dallimet në mes të parametrave mikrobiologjik dhe atyre fiziko- kimik. Aplikimi i standardeve është në interes të gjithë konsumatorëve Prishtinës,F. Kosovë,Obiliqit, Shtimes, Lipjanit, Podujevës,Drenasit,Graçanicës. Departamenti i Cilësisë dhe burimeve të ujit me planin e tij të monitorimit brendshëm të kualitetit të ujit ka në procedurë pikë së pari mbledhjen dhe marrjen e mostrave të ujit të përpunuar nga rrjeti i ujësjellësit, aeratorëve, liqejeve, puseve dhe lumenjve.

Laboratorët shfrytëzojnë metoda standarde për parametrat të cilat janë të aprovume nga BE, sipas procedurës të cilat janë dhënë me Direktivën 98 (93) EC. Mjetet dhe aparatet janë të sofistikuara kurse reagjentët janë të standardizuar dhe me afat. Aplikohet Standardi 17025:2005 ku janë kërkesat që labororet e testimit duhet të plotësojnë nëse ato dëshirojnë të demonstrojnë që ato operojnë një sistem menaxhimi.

Aktivitetet apo përshkrimi i shkurtër i punëve të kryera brenda muajit raportues

Sipas planit tremujor TM4 për monitorimin e brendshëm të kualitetit të ujit në KUR”Prishtina” sh.a, të burimeve sipërfaqësore Albanik, Badovc, Bivolak, Mihaliq (Kanali Ibër-Lepencit) si dhe burimeve nëntoksore Kroni,Obiliq,Shtimje,Lipjan,Peran (Podujevë), Miradi , Graçanicë dheVragoli si dhe pesëmbëdhjetë pikat në rrjetin e qytetit , në aplikim të monitorimit të shpejtë bazik dhe vijues kemi përcjellë kualitetin e ujit të pijshëm në çdo pike mostrimi.

Cilësia e ujit është e kontrolluar dhe testuar me analiza fiziko-kimike dhe bakteriologjike sipas parametrave të cilët janë në Listën A dhe C në Udhëzimin Administrativ Nr.10/2021 për cilësinë e ujit për konsum nga njeriu.

Specifiko disa nga aktivitetet kryesore

Gjatë tremujorit tetor - dhjetor TM4 2022, Departamenti i Cilësisë së ujit dhe burimeve të ujit përveq monitorimit bazik operacional dhe kontrollë të cilësisë së ujit pijshëm është marrë me shumë aktivitete tjera shtesë si përgatitja e raportit mujor, inicimi i kërkesave dhe procedurave për aktivitet prokurimit

publik për Furnizim me klor , Sulfat alumini ,Kalibrim te pajisjeve laboratorike . Vlerësimi i ofertave nga stafi përgjegjës si dhe mbikqyrja e kontratave në realizim e sipër në kuadër te DCBU. Monitorimi i parametrave kimik sipas kontrollit operacional gjatë proceseve teknologjike nëpër faza te ndryshme.Përcaktimi i dozimit të kemikateve sipas metodes Jar-test ,etj.

Punët e planifikuara në shërbime përkatese dhe shkalla e realizimit të tyre

Gjatë TM4 janë planifikuar këto projekte dhe detyra për Shërbimin monitorimi operacional dhe burimet ujore te cilat janë realizuar sipas kërkesës se DCBU. Gjatë tremujorit katër TM4 tetor –dhjetor 2022 ky shërbim ka mbikëqyrë dozimin e kemikateve në te katër FPU dhe stacionet e pompave te ujit ku bëhet trajtimi i ujit me klor,sulfat alumini ,permanganat kaliumi, polielektrolit, hipoklorur natriumi. Kërkesat dhe nevojat për kemikate ,sasia mujore,furnizimi me kohë,etj.

Raporti përmbledhës për NPK “Hortikultura” për kryerjen e shërbimeve të pastrimit të mbeturinave inerte përgjatë sipërfaqes së Liqenit të Badovcit dhe përrockave të tjera që derdhen në liqenin në fjalë, duke marrë për bazë memorandum bashkëpunimi. Inspektim te Liqeni i Badovcit duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ me Nr. 15/2017 kriteret për caktimin e zonave mbrojtëse sanitare të burimeve të ujit. Inspektim te Liqeni i Batllavës duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ me Nr 15/2017 kriteret për caktimin e zonave mbrojtëse sanitare të burimeve të ujit.

Përpilimin e kërkesës për MMPH -ARPL për ndalimin dhe qarkullimin e makinerive me derivate, ku është kërkuar të ndërmerren masat në drejtim të zbatimit të Ligjit mbi Ujërat, Udhëtimit Administrativ dhe Vendimit të Qeverisë për mbrojtjen e burimeve sipërfaqësore të ujit në Liqenin e Badovcit. Inspektim në NJOU-Lipjan, te burimet nëntokësore të ujit me lokacion në Konju dhe te Ish Fabrika e Letrës . Është organizuar aksioni për pastrimin e Liqenit të Badovcit nga mbeturinat, ky aksion është organizuar nga Organizata jo Qeveritare Let's Do It Kosova në bashkëpunim me Hortikulturën. Pjesëmarrës kemi qenë edhe në KRUP-ja dhe nxënësit e shkollës së mesme “ Dr Ali Sokoli”.Kemi realizuar aktivitetin me sukses për pastrimin e mbeturinave rreth brigjeve të liqenit të Badovcit, ku u larguan rreth 200 thasë me mbeturina duke shpresuar se aksionet e thilla të shërbejnë në ndërgjegjësim e popullatës.

Raporti përmbledhës për NPK “Hortikultura” për kryerjen e shërbimeve të pastrimit të mbeturinave inerte përgjatë sipërfaqes së Liqenit të Badovcit dhe përrockave të tjera që derdhen në liqenin në fjalë, duke marrë për bazë memorandum bashkëpunimi. Inspektim te Liqeni i Badovcit duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ me Nr. 15/2017 kriteret për caktimin e zonave mbrojtëse sanitare të burimeve të ujit. Inspektim te Liqeni i Batllavës duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ me nr 15/2017 kriteret për caktimin e zonave mbrojtëse sanitare të burimeve të ujit.

Takim në Komunën e Graçanicës me nënkryetarin z.Leutrim Ajeti, qëllimi i takimit ishte për gjendje shqetësuese ku ndodhen pusetat e valvolave të ajrit në Fabrikën e Badovcit ku në vazhdimësi po hudhen mbeturina të ndryshme. Me qëllim të eliminimit të kësaj gjendje, kemi kërkuar nga Inspektorati i Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit dhe nga Komuna e Graçanicës që në kuadër të kompetencave dhe përgjegjësi që kanë të na ndihmojnë në zgjidhjen e kësaj çështje. Siç jemi të informuar zona në fjalë është caktuar deponi për mbeturina. Kjo zonë është dashur të jetë zonë e mbrojtur për arsye se me këtë trend të ndotjes mund të vie deri te kontaminimi i ujit të pijes përmes formave të ndryshme.Ne sëbashku me z. Ajetin dhe zyrtarët e Komunës së Graçanicës kemi inspektuar në vendin e ngjarjes duke iu dëshmuar rrëzsikshmërin e ndotjes të cilët gjithashtu janë befasuar nga niveli i mbeturinave. Kemi Kërkuar që të ndalohet urgjentishtë hudhja e mbeturinave dhe të e shqyrtojnë mundësinë për zhvendosjen e deponisë së mbeturinave në një lokacion tjetër më të largët nga Objektet e Ujit (Fabrika e Ujit, Valvolat e Ajrimit, Gypat DN 700 dhe DN 600) i cili furnizon me ujë të pijshëm qytetarët e Graçanicës dhe Prishtinës. Nënkryetari i Komunës së Graçanicës premtoj që së shpejti do të marrin masat e duhura.

Shërbimi kualiteti i ujit pijshëm

Departamenti i Cilësisë dhe Burimeve të Ujit si prioritet ka kontrollën e cilësisë së ujit të pijshëm dhe mbrojtjen e burimeve të ujit . Realizimi gjatë tremujorit tretë TM4 2022 ka qenë 3426 mostra total fiziko-kimike dhe bakteriologjike, i cili plan është realizuar për 44 mostra me shumë se sa kanë qenë te planifikuara ose 101.30% te realizuara. Te planifikuara kanë qenë 3382 total mostra, janë realizuar 3426 ose 44 mostra më shumë përshkak te ankesave te konsumatoreve në Zonën e Furnizimit në Prishtinë, NJOU Fushë Kosovë ,Obiliq dhe hulumtimi dhe verifikimi i mostrave pozitive me baktere koliforme në tërë zonën e furnizimit!Te planifikuara për mostra keq ose jashtëstandardeve për ujë të pijshëm për TM4 kanë qenë 30 mostra.

Paraqitja tabelare e rezultateve te testeve të ujit papërpunuar dhe të pijshëm ne aspektin fiziko-kimik dhe bakteriologjik për TM4

Te planifikuara për mostra ne TM4 ne total:	1691 Mostra fiziko-kimike
	1691 Mostra bakteriologjike
	3382Total mostra fiziko-kimike dhe bakteriologjike
Te planifikuara për mostra keq	30 (tridhjetë) mostra jashtë standardit
Numri i i testimeve të planifikuara për mostra te patrajtuara :	556 Total Mostra ujë jo i pijshëm(papërpunuar)
Numri i i testimeve të kryera:	1713 Mostra fiziko-kimike
	1713 Mostra bakteriologjike
	3426 Total mostra fiziko-kimike dhe bakteriologjike
Rezultatet e fituara nga laboratorit:	2872 Ujë pijshëm (përpunuar)
	554 Mostra ujë jo i pijshëm(papërpunuar).
	11 (njëmbëdhjetë) mostra jashtë standardit
Rezultatet e raportuara	Në bazë të analizave kimike dhe bakteriologjike të ujit të trajtuar janë testuar 2872 mostra të ujit pijshëm ku prej tyre mirë janë 2861 ose 99.62% i pergjigjen U.A Nr 10/2021 për cilësinë e ujit për konsum nga njeriu , kurse nuk i përgjigjet njëmbëdhjetë (11) mostra ose 0.38% e mostrave janë jashtë standardit për ujëra te pijshëm. Mostrat jashtë standardit gjatë tremujorit TM4 tetor – dhjetor 2022 janë: Mostra me kod 5058/22 – Cl gjurmë (Pr Ban. e Standardit) - prezent baktere koliforme,total mezofile; Mostra me kod 5062/22 -Cl 0.3 mg/l (Obiliq)- prezent baktere fecal koliforme. Mostra me kod 5867/22 – Cl 0.1mg/l (Lipjan Zyr.e ujës.) - prezent baktere fec. koliforme,koliforme;Mostra me kod 5868/22 – Cl 0.1 mg/l(Lipjan Suhadoll)- prezent baktere koliforme; Mostra me kod 5906/22– Cl 0.1 mg/l (Lipjan Suhadoll) - prezent baktere koliforme; Mostra me kod 5938/22 – Cl 0.1 mg/l (Shkabaj Nr 13) - prezent baktere fec. kolif.,kolif.,total mezofile; Mostra me kod 5974/22 – Cl 0.1 mg/l (Miradi e eperme) - prezent baktere koliforme,total mezofile; Mostra me kod 5983/22 – Cl gjurmë (Shkabaj Nr 3) - prezent baktere fec.koliforme, koliforme; Mostra me kod 5988/22 – Cl gjurmë (Shkabaj Nr 13) - prezent baktere koliforme. Mostra me kod 6254/22 – Cl 0.00 (Dobrevë) ka prezent baktere

	koliforme, total mezofile; Mostra me kod 6281/22 – Cl 0.2 mg/l (Podujevë-Zy.e Ujesj.) - prezent baktere koliforme. Mostrat te cilat kanë dështuar janë marrë sërish ne vendet e njëjta dhe janë punuar për te verifikuar kualitetin e ujit në ato zona dhe rezultatet tregojne se ujë është sipas Standardit për ujë të pijshëm. Kjo ka qenë si pasoje e vershimeve gjate muajit nëntor dhe kontaminim i çastit nga punimet ne teren ose përdorimi i ujit te puseve individuale si alternative nga konsumatorët.
	Gjatë tremujorit TM4 tetor-dhjetor 2022 janë analizuar 554 mostra te ujërave të papërpunuar te cilat i përgjigjen Standardeve për kualitet të ujit të papërpunuar! Ne këtë total te mostrave te ujërave te papërpunauara hynë edhe 28 mostra te ujit sipërfaqësor nga liqeni i Badovcit dhe Batllavës në thellësi dhe distancë te ndryshme te liqenit.
Gjendja e pajisjeve:	E rregulltë dhe funksionale!
Infrastruktura:	Sipas standardeve
Efikasiteti i punës së stafit:	Nivel duhur!
Jokonformitete e hasura:	Nuk ka pas jokonformitete!
Rekomandimet për përmirësim:	Trajnime shitesë për stafin teknik , njoftim me metodologji te re te avancuar!

Aneks: Tabelë krahasuese me periudhën e njëjtë të vitit 2021-2022

Krahasimi i Numrave te mostrave gjatë TM4 2021 dhe 2022, total numri i mostrave, mostra mirë dhe keq ne aspektin bakteriologjik për ujërat e përpunuar, total numri i mostrave, mostra mirë dhe keq ne aspektin fiziko-kimik. Në të dy periudhat 2021 dhe 2022 ne aspektin bakteriologjik dhe kimik kemi 17 mostër te dështuara TM4 2021 dhe TM4 2022 po ashtu kemi 11 mostër të ujit pijshëm të dështuara . Ky numër më i vogël i mostrave te ujit te dështuara në aspektin bakteriologjik gjatë periudhës TM4 2022 se në TM4 2021, për 6 (gjashtë) mostra me pak tregon si tregues i cilësisë më të mirë për këtë periudhe kohore. Në përgjithësi mund te themi se kemi pas një kualitet të kënaqshëm të ujit pijshëm në këtë periudhe kohore .

Parametrat fiziko- kimik vazhdojnë te jenë brenda kufijve te lejuar te ujit pijshëm në zonat e furnizimit te KRU”Prishtina” sh.a.

Viti/TM1	2021/TM4	2022/TM4	Viti/TM4	2021/TM4	2022/TM4
Total mostra FK	1408	1436	Total mostra Bak.	1408	1436
Mostra mire	1408	1436	Mostra mire	1391	1425
Mostra keq	0	0	Mostra keq	17	11

Pengesat dhe sfidat gjatë punës

Në tremujorin e katër nuk ka pas ndonjë pengesë qe ka ndiku në funksionimin punes dhe realizimit te planifikuar për zona mbrojtëse dhe kontrollës se cilësisë se ujit pijshëm .

4.3 Departamenti i Furnizimit me Ujë

Departamenti i Mirëmbajtjes me shërbimet e veta, bënë mirëmbajtjen e rrjetave te furnizimit me uje dhe shërbimi i ujëmatësve ne KRU “PRISHTINA” SH.A, dhe përgjigjet për gatishmërinë e tyre teknike dhe funksionale, e bënë sanimin në çdo kohë dhe në çdo vend në Zonën e shërbimeve të gjitha

defektet , avarit dhe pengesave tjera që paraqiten sa më shpejtë dhe sa më me pak shpenzime duke u mbështetur në radhë të parë në mjetet e KRU-së dhe materialin të cilën e ka në dispozicion.

Ne kuadër të këtij Departamenti Operojnë këto shërbime :

Shërbimi i Rrjetit të Ujit,

Shërbimi i Ujëmatësve,

Shërbimi i Dispečerisë

Gjate periudhës raportuese Shtator - Dhjetor të vitit 2022 në Departamentin e Mirëmbajtjes janë bërë shumë intervenime neper te gjitha shërbimet, te cilat do t'i paraqesim ne tabelën e meposhtme

Objektet e intervenimit	Tetor		Nëntor		Dhjetor		Totali	
							Nëntor- Dhjetor	
	Paraqitja e rasteve	Rastet e kryera	Paraqitja e rasteve	Rastet e kryera	Paraqitja e rasteve	Rastet e kryera	Paraqitja e rasteve	Rastet e kryera
Rrjeti i furnizimit	155	144	112	112	118	118	385	374
Shërbimi i ujëmatësve	69	69	74	74	73	73	216	216
Totali:	224	213	186	186	191	191	601	590

Shërbimi i rrjetit të Ujit

Shërbimi i rrjetit-mirëmbajtja (Emergjente) në periudhën raportuese ka intervenuar në 374 raste të ndryshme, kryesisht në rrjeta me profile të vogla.

Janë realizuar 13 raste të kycjeve të reja për konsumatorë të ri të aprovuar nga DPZH .

Ky shërbim është duke u ballafaquar me problemin e mungesës së stafit sidomos për pjesën periferike të Prishtinës dhe F. Kosovës, ku vetëm me një ekip operohet në këtë pjesë e që është e pamundur të kryhen të gjitha rastet e defekteve me kohë.

Problemi i mirëmbajtjes ka të bëjë edhe me mungesën e mekanizimit respektivisht me ekskavator dhe manipulues të makinave. Departamenti i Mirëmbajtjes, ka nevojë të freskohet me punëtorë të ri, meqë një pjesë është e shtyre në moshe si dhe në gjendje të vështirë shëndetësore.

Shërbimi i Ujëmatësve

Është intervenuar në riparimin e ujëmatësve të ndryshëm, gjithsej 216 raste, në ndërrimin e ujëmatësve. Në vazhdim në mënyrë tabelare është paraqitë numri i ujëmatësve të ndërruar sipas profileve dhe kategorive të konsumatorëve.

Nr	UM-DN/Konsumator/	Shtëpiak	Komerical	Institucional	Kolektiv	Totali
1	/15/	60	15	1		76
2	/20/	90	21	1		112
3	/25/	10	3	1	2	16
4	/32/	1	1			2
5	/40/	1		1	3	5

6	/50/					0
7	/65/				1	1
8	/80/		1	1		2
9	/100/			1		1
10	/150/				1	1
	Totali :	162	41	6	7	216

Shërbimi i Dispeçerëve

Ky shërbim është ne dispozicion 24 h / 7 dite ne javë, ku bëne, harmonizimin e punëve për funksionimin normal dhe kontiunal te tërë sistemit në stacionet e pompimit, FPU dhe në puse te KRU-së.

Për këtë shërbim ka nevojë funksionalizimi i sistemit SCADA-a për menaxhim dhe furnizim me te mirë te ujit te pijes për konsumator.

4.4 Departamenti i Kanalizimit dhe Trajtimi i Ujërave të Ndotura

Qëllimi i Departamentit është organizimi dhe funksionimi i tij për mirëmbajtjen e sistemit te kanalizimit dhe trajtimin e ujerave te zeza duke u bazuar dhe plotësuar standardet sipas udhëzimit administrativ.

Departamenti i Mirëmbajtjes dhe Trajtimin e Ujërave të Ndotura është i përbërë nga:

Shërbimit i Mirëmbajtjes të Rrjetit të Kanalizimit, ku bënë mirëmbajtjen e sistemtemeve të kanalizimit në KRU “PRISHTINA” sh.a, në të gjithë zonën e shërbimit qe përfshin 8 komuna, me gjatësi të rrjetit të kanalizimit 1100 km. Angazhimin e gjithë potencialit të vet, ekspertëve, punëtorëve, mekanizmit dhe pajisjeve teknike që posedon, që të kryejë punët në kohë dhe me rezultate të kënaqshme.

Bënë pastrimin, deblokimin dhe sanimin në çdo kohë dhe në çdo vend në Zonën e shërbimit të gjitha defekteve, bllokimeve dhe pengesave tjera që paraqiten ne kolektor te kanalizimit te ujerave te ndotura urbane .

Shërbimi i Trajtimin të Ujerave të Ndotura

Momentalisht janë tri Impiante te Trajtimin te Ujërave te Ndotura në funksion.

Impiantin e trajtimin të ujërave të ndotura në Halilaq nën zonën kadastrale F.Kosovës

Impiantin e trajtimin të ujërave të ndotura në Mramor – Badoc nën zonën kadastrale Prishtinë

Trajtimi e ujerave te zeza behet duke u bazuar ne udhëzimin administrativ MMPH – Nr.30/2014 për kushtet, mënyrat, parametrat dhe vlerat kufizuese te shkarkimit të ujerave të ndotura ne rrjetin e kanalizimit publik dhe ne trupin uJOR. Ky udhëzim përcakton kriteret e përgjithshme për shkarkimin e ujerave te ndotura, cakton parametrat fiziko-kimike dhe atyre bakteriologjik.

Impiantin e trajtimin te ujerave te zeza ne Halilaq

Impianti përbëhet nga një SBR reaktor (Sequencing Batch Reactors) ku procesi i trajtimin kontrollonhet përmes kompjuterëve industrial, dhe uji i trajtuar me gravitet shkarkohet ne receptor.Kapaciteti i Impiantit është 1230 PE (banor ekuivalent),

Mesatarja ditore i ujerave te ndotur infloë $Q_{24} = 147,6 \text{ m}^3/\text{dite} = 1,71 \text{ l/s}$

Maksimumi ditore i ujerave te ndotur infloë Qd =206,64 m3/dite = 2,39 l/s

2. Impiantin e trajtimit te ujerave te zeza ne Mramor – Badoc

Gypi prurës ne impiant është me diametër 150mm

Impianti përbëhet nga dy SBR reaktor (Sequencing Batch Reactors) ku procesi i trajtimit kontrollohet përmes kompjuterëve të industrial, dhe uji i trajtuar me gravitet shkarkohet ne receptor.

Kapaciteti i Impiantit është 2400 PE (banor ekuivalent),

Maksimumi ditore i ujerave te ndotur infloë Qd = 600 m3/dite = 6.94 l/s

Mesatarja ditore i ujerave te ndotur infloë Q24 =500 m3/dite = 5,78 l/s

Sasia e ujit për dy impiantet ne m3 e trajtuar për muajt:

Impianti i trajtimit të Ujërave të Ndotura Harilaq	Vëllimi i trajtuar m ³	Impianti i trajtimit të Ujërave të Ndotura Mramor	Vëllimi i trajtuar m ³
Tetor	2632		42550
Nentor	2182		43700
Dhjetor	3146		40710
Total:	7960	Total:	126960

Aktivitetet apo përshkrimi i shkurtër i punëve të kryera brenda Muajve;

Gjatë TM4 2022 kemi pas gjithsejtë 769 rasteve te lajmëruara për de bllokim te kanalizimin dhe te gjitha te kryera, pastrim te pusetave dhe vendosje te kapakëve te pusetave në gjithë zonën e shërbimit te KRUP

Krahasim i rasteve te kryera me vitin paraprak :

Viti	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Totali
2021	350	348	323	1021
2022	273	258	238	769

Paraqitja e rasteve te pastrimit te pusetave:

TM4	Pastrim të pusetave	Vendosja e kapakut te betonit dhe konus	Vendosja e kapakut te metalte	Rehabilitim-sanim i rrjetit te kanalizimit
Gjithsej	92	4		

Sipas rregullores nr.10/2019 për standardet minimale të shërbimeve të ujit në Kosovë: i tërë rrjeti i kanalizimit duhet të pastrohet së paku një herë në pesë (5) vjet, dhe të gjitha pusetat e kanalizimit duhet të inspektohen së paku një herë në dy (2) vjet dhe duhet të bëhet pastrimi i tyre varësisht prej nevojës.

Planifikimi vjetor për pastrim të rrjetit të kanalizimit në metra gjatësi

Viti 2022	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Totali
Planifikimi për shpëlarje të rrjetit m'	20000	20000	20000	60000
Realizimi i planit	2100	2150	1780	6030

Planifikimi vjetor për pastrim të pusetave të kanalizimit (në numër).

Viti 2022	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Totali
Planifikimi për pastrim-copë	20	20	30	70
Realizimi i planit	36	41	15	92

Te gjitha rastet të cilat janë të evidentuara në sistem janë të mbyllura.

Specifikimi i disa nga aktivitetet kryesore;

Përveç punëve në de bllokime të sistemit të kanalizimit dhe pastrimit të pusetave në TM4 kemi bërë sanimin e rrjetit të kanalizimit në tri lokacione:

Rruga “Xheladin Hana” DN 315 mm, L= 21.0 m

Rruga “Ahmet Krasniqi” DN 250 mm, L= 3.0m dhe ndërtimi i pusetës (2 elemente 1 konus dhe 1 kapak i kompozit)

Rruga “Gani Butka” DN 315 mm, L= 10.0 m

Në këtë periudhë jemi koncentruar në pastrim të pusetave edhe pse me një kapacitet minimal të fuqisë punëtore, por si rezultat i pastrimit kemi rrënjë të rasteve në deblokime të rrjetit të kanalizimit

Pengesat dhe sfidat gjatë punës: Për de bllokimin dhe pastrimin e numrit të madhë të rasteve të paraqitura dhe arrijen e planifikimeve kemi vështirësi për shkak se në departament kemi mungesë të punëtorëve fizik.

Punët e planifikuara dhe shkalla e realizimit të tyre: Planifikimet për pastrim dhe shpëlarje të kolektorëve për muajin Tetor, Nëntor dhe Dhjetor është arritur.

Te gjitha rastet e bllokimeve të paraqitura janë kryer sipas kërkesave (edhe përkundër mekanizimit mjaft të amortizuar).

Planifikimet dhe Propozimet e propozuar, përkrahje nga menaxhmenti i lartë:

Planifikim për departamentin e DUN me theks të veçantë kemi mungesë e punëtorëve fizik për realizimin e pastrimit të kolektorëve,

Kërkojmë minimum 6 punëtor fizik në mënyrë që të krijojmë edhe 2 ekupe për pastrimin e kolektorëve të rrjetave të kanalizimit (pa pastrime të kolektorëve është shumë e vështirë të mirëmbahet rrjeta e kanalizimit fekal),

Planifikim tjetër autocisternat të kemi përkrahje për blerjen e autocisternave me presion dhe autocisternë thithëse me të avancuar në mënyrë që të kemi mundësi të përballojmë mirëmbajtjen e

rrjetave te kanalizimit, ne te kundërtën me këtë auto mekanizim te amortizuar e kemi shume te vështirë mirëmbajtjen kur dihet se zona e shërbimit është në 8 komunave .

4.5 Departamenti i Ujit të Pa faturuar – UPF

Departamenti i ujit të pa faturuar funksionon me shërbime si më poshtë:

Shërbimi për detektimin e rrjedhjeve

Shërbimi i Kontrollit dhe Lidhjeve

Bazuar ne sasinë e prodhimit dhe faturimit fillimisht ju njoftojmë me shkallen e humbjeve te ujit për periudhën Shtator-Dhjetor për zonën e shërbimit ne KRUP eshte

Tetor 52.78 %

Nëntor 53.92 %

Dhjetor 57.72 %

Uji i pa faturuar – UPF(%) = 54.81 %

Tabela ku paraqitet perqindja e humbjeve pergjate gjithe vitit

Viti 2022	Prodhiimi m³	Faturimi m³	Humbjet ne %
Janar	4,729,455.00	1,946,690.08	58.84%
Shkurt	4,385,263.00	1,917,418.91	56.28%
Mars	4,669,680.00	1,887,200.52	59.59%
Prill	4,672,002.00	1,951,056.68	58.24%
Maj	4,854,223.00	2,041,469.07	57.94%
Qershor	4,751,225.00	2,121,716.37	55.34%
Korrik	4,871,093.00	2,093,768.76	57.02%
Gusht	4,800,984.00	2,157,092.86	55.07%
Shtator	4,474,980.00	2,099,110.47	53.09%
Tetor	4,796,613.00	2,264,785.00	52.78%
Nentor	4,471,512.00	2,060,360.00	53.92%
Dhjetor	4,578,666.00	1,935,507.00	57.73%
TOTAL - 2022	56,055,696.00	24,476,175.71	56.34%

Tabela me humbjet për njësi operative – Muaji Dhjetor 2022

NJOU	TOTALI I DISTRIBUAR m³/muaj	TOTALI I FATURUAR m³/muaj	HUMBJET NE %
NJOU - PRISHTINE	2,949,756.00	1,275,513.00	56.76%
NJOU - GRACANICE	148,281.00	39,252.00	73.53%
NJOU - FUSHE KOSOVE	507,000.00	193,972.00	61.74%
NJOU - PODUJEVE	349,030.00	133,463.00	61.76%
NJOU - OBILIQ	230,827.00	109,367.00	52.62%
NJOU - LIPJAN	207,212.00	93,480.00	54.89%
NJOU - SHTIME	64,710.00	33,488.00	48.25%
NJOU - DRENAS	121,850.00	56,972.00	53.24%
TOTALI	4,578,666.00	1,935,507.00	57.73%

Faktorët që ndikojnë në humbjet e larta të ujit:

Faturimet minimale mujore ndikojnë në mos rritjen e shkallës së faturimit dhe indirekt në humbje

Keqpërdorimet e ujit, rrjedhja në gypa, mosfunksionimi i ujëmatësve, mos lejimi i qasjes në ujëmatës,

Raportimi nga lexuesit për numër të madhe të ujëmatësve që vazhdojnë të jenë jashtë funksionit,

Faturimi vetëm me tarifë fikse për konsumatorët që nuk kanë të instaluar ujëmatës individual sipas rregullores së ARRU-së vazhdon të jetë një sfidë në vetë dhe në dëm të kompanisë. Konsumatorët hezitojnë të vendosin ujëmatës dhe vështirësojnë qasjen e lexuesve dhe inspektorëve në shumë raste,

Amortizimi i rrjetave shpërndarëse, rritja e kohës nga raportimi deri në riparimin e rrjedhjes, mungesa e personelit të operativës është një faktor i lartë që ndikon në rritjen drejtpërdrejtë të humbjeve fizike të ujit.

Shërbimi për detektimin e rrjedhjeve

Duhet cekur se shërbimi për detektimin e rrjedhjeve të Ujit ka mungesë të stafit punës pasi përbehet vetëm nga dy inspektorë (numër jashtëzakonisht i vogël). Edhe përkundër kësaj Shërbimi ka funksionuar mirë duke bërë kontrole aktive në rrjetat e ujësjellësit në tërë zonën e shërbimit dhe njëkohësisht ka mbështetur ekipet e shërbimeve tjera si: Mirëmbajtja e Rrjetit, Makinaria, Elektro, Shërbimi i Ujërave të ndotura etj. Duhet cekur se Shërbimi ka ndihmuar - asistuar edhe të gjitha NJOU, në total 367 raste të detektimit.

Detektimin e Rrjedhjeve, lokacioni i rrjedhjeve të dukshme të raportuara nga personeli i ujësjellësit, qytetarët dhe institucionet e tjera.

Punë me aparaturë për gjetjen e sakte të infrastrukturës nëntokësore siç janë: tubacionet, armaturat, kapakët metalik, kablo nëntokësore (KEDS, IPKO, PTK) të mos dëmtohen infrastruktura e tyre gjatë intervenimit të operativës.

Kontrollimi i ujëmatësve zonal dy herë në muaj në zonën e shërbimit dhe analiza e tyre.

Kontrollimi dhe detektimi i rrjedhjeve të padukshme (nëntokësore).

Tabela nr. 1: Aktivitetet e Shërbimit për detektimin e Rrjedhjeve

Viti 2022	Tetor	Nëntor	Dhjetor	TM4
Detektimi i rrjedhjeve	108	109	150	367
Detektimi i rrjedhjeve të padukshme	25	19	42	86
Detektim të infrastrukturave	29	32	38	99
Kontrolla DMA	5	5	5	15
Kontrolla aktive e rrjetit (km)	13.0	10.5	10.0	33.5

Leximi i rregullt i ujëmatësve zonal:

Vazhdon mos leximi në kohe reale për zonat DMA si shkak i skadimit të kohës së mirëmbajtjes së data loggerave të prodhuesit përkatës HËM (Halma Eater Management), leximi bëhet në mënyrë manuale në terren.

Instalimi i softueri i kompanisë Gjermane SEBA pasi edhe produkti është i së njëjtës kompani nga cila bëhet edhe transportimi i të dhënave çdo 24 orë për pulset e rrjedhjes dhe presionit çdo 10 minuta.

Zonat e reja matëse (DMA) janë ndërtuar në këto NJOU:

Ne zonën e rrjetit të Prishtinës janë vendosur 3 UZ(Ujemetës Zonal)

Ne zonen e rrjetit shpërndarës ne Drenas janë te vendosur 2 UZ.

Ne zonen e rrjetit shpërndarës ne Lipjan janë vendosur 3 UZ.

Ne zonën e rrjetit shpërndarës ne Podujeve janë vendosur 3 UZ.

Shërbimi i detektimit dhe rrjedhjes është shumë i vogël në personel kur dihet shpërndarja e rrjetit të ujësjellësit në tere zonën e shërbimit. Kërkesat nga Departamenti janë që të rritet ky shërbim me personel përkatës si dhe të trajnohet në fushën e humbjeve të ujit sipas metodologjive dhe teknologjive të reja të cilat sot janë tepër të avancuara.

Shërbimi i Inspektimit dhe Shkyqjeve

Njesia-Task Forca-Shkyçjet

Aktivitetet	Tetor	Nëntor	Dhjetor	TM4
Vendosje e UM të Ri	3	0	0	3
Raste të Rrjedhjeve	1	1	0	2
Inspektime,keqpërdorime ilegale	141	70	34	245
Vizita për Borgje	607	847	1,014	2,468
Shkyqjet për borgje të pa-paguara	9	14	12	35
Rikyqje të rregullta pas pagesës së borgjit	0	4	6	10
Numri i pagesave pas vizitës	226	310	374	910
Totali i pagesave pas vizites	€ 54,263.00	€ 88,795.00	€ 84,156.00	€ 227,214.00
Kyqje ilegale	3	9	11	23
Shkyqjet ilegale pa faturë, pa UM, N.N.	7	4	10	21
Rikyqje pas kërkeses për legalizim	0	1	0	1
Shkyqje ilegale jashtë UM,me faturë	0	0	0	0
Konsumatorët me UM, pa regjistruar	13	20	9	42
Vërejtje				

Aktivitetet për zvogëlimin e UPF-se (departamenti përkatës)

1. Problemet e hasura gjatë kësaj periudhe nuk janë të pakta, ku një ndër problemet që po na përcjell me vite të tëra është mungesa e punëtorëve, ku siq jeni të informuar në të dy shërbimet kemi mungesa të konsiderueshme të stafit.

2.Masat e realizuara/ mos realizuara nga periudha paraprake, siq e sqarova mungesa e punëtorëve është pengesa kryesore e mos realizimit të shumë aktiviteteve që kemi planifikuar të realizojmi, të ju sqaroj se Shërbimi për detektimin e Rrjedhjeve të Ujit funksionon me një Teknik dhe 2 Ujëinstalues, derisa tereni është voluminoz duke përfshirë vet Prishtinën dhe 7 komuna tjera gjë që vështirë për tu arritur. Derisa Shërbimi për Inspektim dhe Shkyqje funksionon me vetëm 4 Inspektorë gjë që edhe në këtë shërbim kemi ngecje të mëdha.

3. Masat e propozuara për periudhën në vazhdim: Duhet me pas parasysh që sipas mundësisë të rritet stafi në të dy Shërbimet në mënyrë që të jemi më të pregaditur së paku për nga numri të kemi mbulueshmëri më të madhe të terrenit.

4. Aktivitetet për zvoglimin e UPF-se (kete vetem departamenti perkates),

Nëse do të kemi përkrahje më të madhe nga menaxhmenti i lartë si dhe mbështetje nga Departamentet e tjera për realizimin e disa kërkesave tona edhe rezultatet nuk do të mungojnë:

Kompletimi i stafit me mungesat që i kemi e që janë të shumta në të dy Shërbimet;

Formimi i së paku edhe 2 ekipeve për detektim të rrjedhjeve të ujit (njëri ekip të punojë vetëm gjatë natës);

Formimi – krijimi i sa më shume DMA zonave që janë një mbështetje shumë e madhe dhe shumë më lehtë e managjueshme,

Ndërmarrja e aksioneve të drejtpërdrejta në zona të caktuara për detektim të kyqjeve ilegale dhe problemeve tjera që kanë ndikim të drejtpërdrejtë në luftimin e humbjeve të ujit,

Pika paraprake kërkon mbështetje më të madhe nga menaxhmenti dhe departamentet tjera,

Mungesa e lexuesve (leximit) që ndonjëherë leximi nuk bëhet në mënyrë të rregullt dhe faturimi bëhet me mesatare pa lexim

4.6 Departamenti i Planifikimit dhe Zhvillimit

Qëllimi i Departamentit është organizimi dhe funksionimi i saj në planifikimin dhe zhvillimin e projekteve si dhe zhvillimin dhe integrimin e të dhënave në data bazën e GIS duke u bazuar dhe plotësuar standardet sipas ligjeve dhe udhëzimeve administrative në fuqi.

Përveç operimeve ditore teknike merret edhe me analizë analitike të gjithë treguesve teknik dhe financiar të përcaktuar nga Autoriteti Rregullator i Ujit.

Zyra e Planifikimit dhe zhvillimit në vete përmban dy shërbime:

Shërbimi i projektimit dhe planifikimit

Shërbimin e GIS-it

Shërbimi i projektimit dhe planifikimit bënë analizimin dhe projektimin e projekteve të infrastrukturës dhe planeve zhvillimore në KRUP :

Analizimin dhe hartimi i projekteve në kuadër të KRU "Prishtina"

Analizimi i kërkesave për kushte teknike, kërkesave për lidhje uji, dhe përgatitja e pëlqimeve.

Inspektime dhe matjet e nevojshme për lëshimin e pëlqimeve për lidhje në sistemin e ujësjellësit dhe kanalizimit.

Vlerësimin, mbikëqyrjen e projekteve të parapara në planin e prokurimit për vitin 2022 që kanë vazhduar edhe në tremujorin e katërt të vitit 2022.

Projektit- Menaxhimi i integruar i aseteve në KRU-Prishtina

Analizimi dhe përpilimi i zgjidhjeve teknike në fazën e kërkesave për kushte teknike

Analizimi dhe përpilimi i zgjidhjes teknike në fazën e kërkesave për kyçje

Bashkëpunimi me nivelin qendror dhe lokal për investime të përbashkëta në tërë zonën e shërbimit të KRU-P.

Angazhimi i shërbimit për planifikim dhe zhvillim për TM4 janë si më poshtë:

Mbledhja e informacioneve nga terreni, për hartimin e Projekteve dhe specifikacioneve teknik për Rehabilitimin e Rrjetave ekzistuese që ndikojnë në përmirësimin e furnizimit me ujë dhe zvogëlimin e humbjeve fizike në zonën e shërbimit që do të realizohen në vitin 2023 sipas Biznis Planit.

Analizimin dhe incizimin e terrenit për hartimin e projektit të rrjetit të ujësjellësve dhe kanalizimeve.

Analizimi dhe inspektimi i gjendjes ekzistuese për përpilimin e projektit për Rehabilitimet e objekteve në KRUP (rehabilitimi ndërtimor, makinerike dhe elektrik i objekteve prodhuese)

Përpilimi i projekteve dhe specifikacionit teknik për rehabilitim të rrjetave të ujit dhe kanalizimit në bashkëfinancim me komunat në zonën e shërbimit.

Përgatitja e para masës dhe specifikave teknike për projektin e instalimit të ujëmatësve dhe ujëmatësve zonal në zonën e shërbimit.

Zyra për Projektim ka hartuar projektet për zbatim të cilat kanë qenë në planin e Prokurimit për vitin 2022.

Zyra për projektim ka hartuar projektet për zbatim sipas kërkesave të ministrive përkatëse për hartimin e projekteve në komunën e Fushe-Kosoves për lagjet 028 & 29 në qytet si dhe projektet për rehabilitim të rrjetave për fshatrat Sllatine dhe Bardhi i Madh, këto projekte do të financohen me buxhetin e Qeverisë së Kosovës.

Zyra e projektimit ka hartuar projektin për furnizim me ujë për fshatin Batusha që do të financohet me buxhetin e Komunes së Gracanices si dhe ka hartuar projektin ideor për rehabilitimin e fshatit Kishnice në KK-Graçanice.

Është dorëzuar projekti për zbatim për ndërtimin e DMA zonave në tërë zonën e shërbimit ky aktivitet është i planifikuar në planin e Prokurimit për 2022.

Mbikqyrja e projekteve që janë në ndërtim e sipër.

Angazhimi me zyrën e aseteve për regjistrimin e aseteve të reja pas pranimit teknik dhe futjes në operim.

Tabela nr. 1-Lista e projekteve për zbatim të parapara në planin e prokurimit

Hartimi i Projekteve për Zbatim në periudhën raportuese të TM4 nga DPZH-se			
	Emërtimi i Projektit	Projekti përfunduar	Projekti në proces
1	Furnizimi dhe montimi i ujëmatësve zonal në pikat e trajtimit, ujëmatës kontrollues, rregullator presioni përfshirë ndërtimin e pusetave.	po	Projekti është dorëzuar më datë: 15.11.2022 tek Prokurimi

Tabela 2: Mbikqyrja e Projekteve dhe statuti i tyre - periudha, Tetor – Dhjetor 2022

Mbikqyrja e Projekteve gjatë periudhës së raporteve të TM4 nga DPZH-se			
	Emërtimi i Projektit	I përfunduar	Progresi

1	Nderrimi dhe ndertimi i rrjetit të ujit për përmirsimin e furnizimit dhe zvogëlimin e humbjeve në zonën e shërbimit të KRU Prishtina sh.a Prishtinë” me numër të ref: Lot 1 704433736-22-5063-5-2-1/C199 të datë 16.08.2022 Lot 2 704433736-22-5063-5-2-1/C200 të datë 16.08.2022	Ne ndërtim	80% e realizuar
---	---	------------	-----------------

Aplikimi dhe shqyrtimi i lëndëve nga konsumatorët në DPZH.

Tabela 3: Lista e lëndëve periudha, Tetor – Dhjetor 2022

Lendet e DPZH-se					
		Te Pranuar	Te Shqyrtuar	Ne Shqyrtim	Te mbyllura ne CRM
1	Pëlqime për kycje	48	31	17	31
2	Kushte Teknike	110	107	3	107
3	Përgjigje në kërkesa	17	17	0	17
4	Legalizim ujëmatësve kolektive	24	24	11	13

Shërbimi i Gjeodezisë dhe GIS

Shërbimi i GIS dhe gjeodezisë në këtë raport të TM4 paraqet të gjitha punët të cilat kanë qenë të drejtuara në departament si dhe ka qenë në shërbim të gjitha departamentet të cilat kanë kërkuar të dhëna.

Në kuadër të punëve dhe veprimeve operative janë ndërmarrë këto aktivitete gjatë periudhës tremujore si më poshtë.

Shqyrtim të kërkesave për dhënie të informacioneve dhe lëshimi i pëlqimeve, azhurnimi i rrjetës së re, përpunimin e shënimeve ekzistuese. Këto informacione janë siguruar në bashkëpunim me Departamentin e Operativës.

Konvertimi i rrjetit, pusëve dhe elementeve, modifikim dhe unifikimi i rrjetit, pusëve dhe Data bazës së shënimeve në GIS.

Pranimi dhe procedimi i të dhënave digjitale (ujëmatësve individual dhe kolektiv) për azhurnimin në bazën të dhënave në GIS.

Matjet gjeodezike për përpilimi dhe zbatimin e projekteve.

Asistencë tek lexuesit për kalimin e Aplikacionit MyMaps nga App në Web platforme për vendosjen e lokacioneve të konsumatorëve në hartën e GIS-it deri më tani në këtë platformë janë vendosur afërsisht 10113 konsumator.

Vazhdim-Perpunimi i të dhënave nga matjet e drejtpërdrejta në terren, pusëve, skicave gjatë, për projektin MIA – Menaxhimi i Aseteve.

Perpunimi i shënimeve për një pjesë të elaboratit të shpronësimit për rrjetin e projektuar të kolektoreve të impiantit

Projekti i menaxhimi të integruar i aseteve në KRU-Prishtina

Vazhdojn aktivitetet e njëjta nga TM3 në TM4 për projektin e lartecur si më poshtë.

Identifikimi dhe regjistrimi i aseteve teknike të kompanisë

Grumbullimi dhe gjeoreferncimi i të dhënave ekzistuese

Analiza e të dhënave ekzistuese

Përpunimi dhe përshtatja e të dhënave për konvertim në platformën softëerike EDAMS

Konfigurimi i të dhënave në EDAMS

Krijimi i planit për menaxhimin e programit MIA

Plotësimi i formularëve të Sistemit të Menaxhimit të Aseteve

Konvertimi i data bazës aktuale të CRM-së në platformën MMS Edams.

Projektit përveç monitorimit (që do të vazhdojë në mënyrë permanente) përfshinë edhe Menaxhimin e Mirëmbajtjes, ka për qëllim vlerësimin sistematik të gjendjes së rrjetit, mirëmbajtje efikase të infrastrukturës dhe kontrollin e kostos së mirëmbajtjes.

Bazuar në rezultatet e të dhënave deri më tani kemi arritur të krijojmë një regjistër të aseteve me të dhëna faktike, të besueshme dhe referenca gjeografike përmes platformës softuerikë EDAMS. Këto të dhëna mund të vlerësohen pa vështërsi duke zbatuar funksionet e procesit. Ndërsa me anë të shfrytëzimit të Sistemit të Menaxhimit të Mirëmbajtjes do të arrijmë vlerësimin sistematik të gjithë gjendjes së rrjetit duke u bazuar në të dhënat e shërbimeve të KRUP-së.

Planifikimet për muajin në vazhdim:

Planifikohen punët e ngjashme, si dhenja e pelqimeve dhe informacioneve, matje në terren për projektet e reja, matje për projektin MIA, vazhdim i ndarjes së zonave për digjitalizimin e planeve etj.

Aktivitetet dhe Rezultatet

Gjatë periudhës tre mujore në programin e Menaxhimit të dhënave është punuar në azhurnimin e rrjetit të NJOU-së Lipjan dhe rregullimit dhe transformimit të rrjetit të NJOU-ve Prishtinë, Podujevë dhe Drenas. Përveq të dhënave të cekura janë kryer edhe aktivitetet në sistemin e Menaxhimit të Mirëmbajtjes si: regjistrimi i kërkesave teknike, krijimi i kartelave të punës dhe mbyllja e disa prej rasteve.

Aktiviteti i PMA-se

Statusi	Në progres
Objektivi	Krijimi i rexhistrit të aseteve për nevojën dhe përfitimet e Menaxhimit të Integruar të Aseteve në infrastrukturën e ujit dhe kanalizimit si dhe Menaxhimi i Mirembajtjes.
Data e aktiviteve	Viti 2022: Tetor- Dhjetor 2022.
Progresi	Aktivitetet kanë filluar nga muaji Tetor 2022, duke vazhduar me përpunimin e të dhënave.

Aktivitetet	Azhurnimi i rrjetit të ujit për NJO-ne Lipjan. Rregullimi dhe transformimi i të dhenave të rrjetit të NJOU-ve Prishtine, Podujeve dhe Drenas. Azhurnimi i të dhenave të infrastruktures mbi tokësore të KRUP-se. Krijimi i Hartave për nevojat e KRU-se. Futja e të dhenave të konsumatoreve të rinjë në sistemin e GIS-it etj.
Planifikimi:	Ndërtimi automatik i sistemit të GIS-it, duke përfshirë blerjen e paisjeve dhe programeve të licencuara. Shfaqja e të dhenave në Aplikacionin GIS Online. Azhurnimi i të dhenave të infrastruktures ujore dhe kanalizimit. Azhurnimi i të dhenave të konsumatoreve dhe lidhja permanente e tyre me bazen e faturimit. Futja e konsumatoreve të rinjë në aplikacionin GIS. Analiza të ndryshme varsisht nga nevojat e kërkesës së KRUP-se. Shfrytëzimi i sistemit nga të gjitha departamentet dhe NJOU-te e KRUP-se etj.

Aktiviteti i MIA

Statusi	Në progres
Objektivi	Krijimi i Planit të Menaxhimit të Aseteve.
Aktivitetet	Planifikimi i zgjerimit dhe ripërtirjes së infrastruktures ujore dhe të kanalizimit, vlerësimi i kritikalitetit dhe shërbyeshmerisë së asetëve si dhe investimet kapitale.
Progresi	Rreth 80% e të dhënave aktive në KRUP, të përpunuara rreth 75% ndërsa të konvertuara në platformën softverike 75%. Pjesa tjetër pritet të azhurnohet gjatë vitit 2023.
Rezultatet e Krijuara	75 % e infrastrukturës ujore (rrjeti ujor) me elementet e përbëra si rezervuar, stacione të pompave, puse ujore, valvula, ujëmatës zonal dhe konfigurimin e tyre konform të dhënave për menaxhim të asetëve.
Planifikimi:	Gjatë vitit 2023 parashihet të përfundoj: Vlerësimi i asetëve mbitorësore. Regjistrimi i defekteve të rrjetit të ujësjes dhe kanalizimit në GIS. Azhurnimi i infrastruktures ujore dhe të kanalizimit. Hartimi i PMA-se në nivel të kenaqshëm.

4.7. Divizioni i Autoparkut

Divizioni i autoparkut operon me automjetet të udhëtarëve, automjetet transportuese si dhe automakina punuese, të gjitha këto automjete tashmë janë në kohën e eksploatimit maksimal.

Si rrjedhojë e vjetërsisë kemi shumë vështirësi që të mbahet teknikisht në gjendje maksimale operative. Kemi në planifikim që shumë nga këto të zëvendësojmë por shkak i buxhetit të limituar duhet të mirëmbajmë ashtu si i kemi mundësit. Me angazhimin e Divizionit si dhe OE të kontraktuar kemi arritur që auto mekanizimin ta mbajmë në gjendje të kënaqshme funksionale.

Planifikimet për muajtë e vazhdim:

Mirëmbajtjen makinerive të Autoparkut, publikimin e tenderit për mirëmbajtjen e Bagerëve-Kamioneve-Cisternave-Kamionetave dhe Gjeneratorëve në objekte të KRUP.

Sfidat më të cialt ballafaqohemi si shërbim me mungesën e punëtorëve – shofer, automekanik dhe auto elektrikist.

Raporti i Autoparkut Tetor-Dhjetor 2022

Total

Kilometra e kaluara + Orë/pune	Litra Naftë	Litra Benzinë
184691	31214	1211
Shpenzimet e lëndës djegëse për TM-4 TETOR + NËNTOR + DHJETOR 2022	Kilometra të kaluara	Naftë dhe benzinë e shpenzuar- litra
	184691	Litra naftë = 31214
		Litra benzinë = 1211
		32425

5. Departamenti i Prokurimit

Raporti mbulon periudhën prej 1 tetor deri me 31 dhjetor (TM4) të këtij viti dhe jep informacione rreth gjendjes së aktiviteteve të prokurimit, me theks të veçant në kërkesat e inicuar, të painicuar, investimet kapitale, aktivitetet jasht planit të prokurimit si dhe kontratat e nënshkruara, për periudhën përkatëse.

Raporti ka këtë renditje:

- Aktivitetet e inicuar sipas planit TM4;
- Aktivitetet e inicuar me vonesë TM4;
- Investimet kapitale TM4;
- Aktivitetet jasht planit të prokurimit TM4; dhe
- Numri dhe vlera e kontratave të nënshkruara TM4

Aktivitetet e inicuar sipas planit TM4

Gjatë kësaj periudhe, janë inicuar 2 aktivitete të planifikuara, në vlerë financiare prej 113,000 euro. Aktivitetet e inicuar janë procesuar pa vonesa. *Detajet në tabelën 1.*

Aktivitetet e inicuar me vonesë TM4

Gjatë kësaj periudhe, nga departamentet apo njësitë kërkuese, janë inicuar me vonesë 7 aktivitete. Fjala është për aktivitete të cilat është dashtë të inicohen në periudhat e mëhershme por që janë inicuar në këtë periudhë. Vlera e tyre financiare është 407,300 euro dhe të gjitha janë procesuar pa vonesa *Detajet në tabelën 2.*

Investimet kapitale TM4

Gjatë periudhës TM4, në emër të investimeve kapitale, kanë qenë të parapara për inicim 3 aktivitete, në vlerë të parashikuar financiare prej 165,000 € dhe të gjitha janë inicuar dhe procesuar brenda afatit të paraparë. *Detajet në tabelën 3.*

Aktivitetet jasht planit të prokurimit TM4

Gjatë periudhës raportuese, si aktivitete jasht planit të prokurimit, kemi pasë të inicuar 3 aktivitete, në vlerë të parashikuar financiare prej 49,950 euro dhe të gjitha janë procesuar pa vonesë. *Detajet në tabelën 4.*

Numri dhe vlera e kontratave të nënshkruara TM4

Në periudhën TM4, kemi nënshkruar 6 kontrata, në vlerë financiare prej 230,211 euro. *Detajet në tabelë*

Vështirësitë gjatë TM4

Vështirësitë e shfaqura gjatë kësaj periudhe, mund të klasifikohen si të jashtme dhe të brendshme.

Si vështirësi të jashtme mund të cekim:

Vështirësitë në ekzekutimin e kontratave ekzistuese, si pasojë e ndryshimeve në tregun global, dhe

Dështimi i disa aktiviteteve, si pasojë e mosdorëzimit të ofertave poashtu si pasojë e ndryshimeve në tregun global;

Si vështirësi të brendshme mund të cekim:

Inicimi me vonesë i disa aktiviteteve të planifikuara të prokurimit;

Vonesa në menaxhimin e kontratave, dhe

Vonesa në përpilimin e të dhënave/specifikacioneve teknike.

Masat e propozuara për periudhën në vazhdim

Ne lidhje me vështirësitë e jashtme, për të tejkaluar keto vështirësi, tashmë kemi inicuar dhe kontraktuar kontrata afatshkurtëra, me afat më të shpejtë të ekzekutimit. Nga kjo, presim që të kemi operator më stabil dhe kontrata më të qëndrueshme. Përpos kësaj, kemi thjeshtësuar kërkesat kualifikuese, duke “zbutur” këto kërkesa ndaj operatoreve por pa dëmtuar mbarëvajtjen e veprimtarisë së ndërmarrjes dhe njëkohësisht duke rritur kujdesin që ndërlidhet me ekzekutimin e kontratave;

Sa u përket vështirësive të brendshme, që lidhen me iniciimet e vonuara, vonesat në menaxhim të kontratave apo me përpilimin e specifikacioneve teknike, tanimë janë propozuar këshilla konkrete për të pasë planifikime më të mira të aktiviteteve, në mënyrë që të mos ketë dilema kur vije te momenti i iniciimit. Kjo kërkon rritje të angazhimit rreth përpilimit të specifikacioneve teknike dhe në fund edhe rritje e bashkëpunimit të menaxherëve të kontratave me Kryeshefin (ZKA) dhe me Departamentin e Prokurimit (ZKP)..

Tabela 1. Aktivitetet e inicuar sipas planit_TM4

Nr.	Përshkrimi	Periudha e iniciimit	Vlera e parashikuar	Inicuar	Gjendja
1	Furnizimi me pajisje për rehabilitimin dhe ndërtimi e sistemit të klorimit të lengët dhe të gazët në objektet përcjellëse në KRU Prishtina sh.a. (realizuar pjesërisht).	10.10.2022	73,000	Po	E realizuar
2	Mirëmbajtja vjetore e datalogerëve dhe qasja në kohë reale për marrje dhe përpunimi të informacioneve për DMA zonat në tërë zonën e shërbimit_kk 2 vjeçare.	10.10.2022	40,000	Po	E realizuar
Gjithsejt			113,000		

Tabela 2. Aktivitetet e inicuar me vonesë_TM4

Nr.	Përshkrimi	Periudha e paraparë për iniciim	Periudha e iniciimit	Vlera e parashikuar	Gjendja
1	1.Furnizimi dhe montimi i ujëmatësve me profile Fi 1/ 2 deri 2 për ndërrimin e ujëmatësve ekzistues në pajtim me rregullat e parapërcaktuara, në zonën e shërbimit_Lot 1; 2.Furnizimi dhe instalimi i ujëmatësve zonal, ujëmatësve në pika të trajtimit, ujëmatës kontrollues dhe rregullator të presionit në zonën e shërbimit të KRU Prishtina Sh.a. (përfshirë pusetat) dhe llogoret e presionit_Lot 2 3.Furnizimi dhe montimi i ujëmatësve në objektet prodhuese në FPU_Lot 3	08.04.2022	11.11.2022	235,000	Në proces
3	Percaktimi i zonave mbrojtëse - Ngritja dhe mirëmbajtja e burimeve ujore	09.09.2022	13.10.2022	20,000	Në proces
4	Digjitalizimi i proceseve të brendshme (dorëzuar pjesërisht) -Furnizimi me rampa(laura) digjitale dhe mirëmbajtje	10.09.2022	15.11.2022	26,000	Në proces
5	Shërbime të mirëmbajtjes së ËEB faqes dhe pagesat vjetore domain + SSL Certifikatat dhe fireëall licenca	10.05.2022	18.11.2022	3,000	Në proces

6	Furnizim me sulfat alumini	08.04.2022	22.11.2022	120,000	E realizuar
7	Furnizimi me materiale promocionale	10.03.2022	25.11.2022	3,300	E realizuar
Gjithsejt				407,300	

Tabela 3. Investimet kapitale_TM4

Nr.	Emërtimi	Periudha e paraparë për inicim	Vlera e parashikuar	Inicuar	Gjendja
1	Furnizimi me pompa centrifugale horizontale dhe vertikale si dhe pompave zhytëse përfshirë edhe pajisje (frekuentor) në stacionet e nxjerrjes dhe shtytjes.	nëntor	45,000	Po	Në proces
2	Zhvillim i modulit call center, hardueri i nevojshëm dhe nderlidhje me billing dhe mirembajtje e komplet billing dhe call center (dorezuar pjeserisht)	tetor	40,000	Po	Në proces
3	Furnizimi me ekskavator për mirëmbajtjen e rrjetit të ujësjellësit dhe ujërave të ndotura dhe kamionë	nëntor	165,000	Po	E anuluar
Gjithsejt			250,000		

Tabela 4. Aktivitetet jasht planit të prokurimit_TM4

Nr	Përshkrimi	Vlera e parashikuar	Gjendja
1	Auditimi i pasqyrave financiare te KRUP sha, për vitet 2022,2023 & 2024	22,000	E anuluar
2	Furnizimi me letër A4 (pas shkëputjes së kontrates, deri ne perfundimt te ritendermit)	950	E realizuar
3	Furnizimi me invertorë dhe bateri	27,000	Në proces
Gjithsejt		49,950	

Tabela 5. Numri dhe vlera e kontratave të nënshkuara_TM4


Nr.	Përshkrimi	Vlera e parashikuar	Vlera e kontrates	Operatori Ekonomik
1	Furnizim me fazoneri e armatura-pas ankeses në OSHP për tenderin e fazoneri e armatura	9,900	9,895	Tora Com
2	Furnizimi me ujëmatës dhe blloomba për ujëmatës si dhe module RF më montim_kk 2 vjeçare	62,000	59,612	Patela SH.P.K
3	Materiale zyrtar administrativ dhe fatura për konsumator_kk 2 vjeçare (ri-tender pas shkëputjes së kontratës nr.KRUP-22-004-1-2-1)	40,000	40,000	Grafo Loni
4	Furnizimi me letër A4 (pas shkëputjes së kontratës, deri në përfundim të ritenderit)	950	712	GrafoLoni
5	Furnizim sulfat alumini	120,000	118,000	Trepça
6	Furnizimi me materiale promocionale	3,300	1,992	BMS Solutions
Gjithsejt		236,150	230,211	

6. Njësitë Operative

Gjatë TM4 te vitit 2022, aktiviteti i nëpër Njësi Operative ka rritur dinamikën e aktiviteteve të punës që ndërlihen me indikatorët e faturimit dhe me theks të veçantë inkasimin. Marrë parasysh që shkalla e faturimit në Njësi operative ka shënuar një rritje të jashtëzakonshme në raport me planifikimin dhe në raport me periudhën e njejtë të vitit paraprak gjatë vitit 2022, i gjithë mobilizimi i stafit nëpër njësi është orientuar drejt rritjes së inkasimit në mënyrë që të sigurohet likuiditeti i qëndrueshëm për ndërmarrjen.


Në përgjithësi, performanca gjatë TM4 në Njësi Operative ka qenë në një nivel dukshëm më të lartë krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Sa I përket shkallës së faturimit, është shënuar një shkallë e njëjtë e faturimit me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Gjatë TM4 të vitit paraprak, ishin faturuar 2,151,000m3, kurse në periudhën e njëjtë të vitit 2022 janë faturuar 2,129,000 m3.

Grafiku 1. Faturimi m3, TM4 2021 dhe TM4 2022




Faturimi i shprehur në vlerë monetare në periudhën e njëjtë të vitit paraprak ka qenë 1,324,000 euro, kurse në gjatë TM4 të vitit 2022 faturimi në nivel të njësive operative ka qenë 1,388,000 euro. Për periudhën e njëjtë në vitin 2022 kemi një rritje të shkallës së faturimit të shprehur në vlerë monetare prej mbi 64,000 euro ose shprehur në përqindje 4.8%.

Grafiku 2. Faturimi i shprehur në vlerë monetare në gjashtëmuja të parë 2021 dhe 2022



Shkalla e inkasimit ka qenë në një nivel dukshëm më të lartë gjatë TM4, 2022 krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Gjithsej në nivel të njësive operative janë inkasuar mbi 400,000 euro më shumë se periudha paraprake, nga 1,178,000 euro në 1,470,000 euro.

Grafiku 3. Shkalla e inkasimit gjatë TM4 2021 dhe TM4 2022



Raporti në vijim paraqet aktivitetin e punës së Njësive operative i strukturuar sipas natyrës së aktiviteteve (inspektim, administratë dhe teknikë)

Aktivitetet e inspektimit sipas Njësive

Aktivitetet e ndërmarra në aspektin e inspektimit kanë për qëllim që të sigurojnë faturim korrekt të konsumatorëve, identifikimin e kyçjeve ilegale, bllobimin e konsumatorëve, shkyçjen dhe rikyçjen e konsumatorëve si dhe shpërndarjen e vërjetjeve konsumatorëve të cilët kanë obligime ndaj ndërmarrjes. Tabela më poshtë paraqet dinamikën e punës sipas njësive në raport me inspektimin:

Tabela 1. Aktivitetet e njësive të Inspektimit sipas Njësive operative.

	Inspektime	Bllombime	Kyçje Ilegale/te pa regjistruar	Shkyçje	Rikyçje	Verejtje per obligim
Lipjan	659	45	15	2	0	257
Shtime	100	24	0	0	0	593
F.Kosovë	809	120	0	0	0	1,314
Podujevë	960	44	0	0	1	552
Drenas	601	36	14	12	9	384
Obiliq	120	0	0	0	0	350
Graganicë	NA	12	0	0	0	630
TOTAL	3,249	281	29	14	10	4,080

*Sqarim, Njësia e Graqanicës nuk posedon personel të inspektimit dhe ky aktivitet menaxhohet nga qendra së bashku me Prishtinën.

Në total gjatë TM4 2022, janë inspektuar 3,249 konsumatorë, janë vendosur 281 bllomba dhe janë identifikuar 29 kycje ilegale (nga të cilët pjesa dërrmuese janë konsumatorë të cilët nuk kanë bërë kërkesë për kycje). Për më shumë, janë shqiptuar 4,080 vërejtje, konsumatorëve të cilët kanë obligime ndaj ndërmarrjes.

Aktivitetet Administrative sipas Njësive

Aktiviteti administrative përfshinë një gamë të gjerë të punëve të përditshme duke filluar nga regjistrimet e konsumatorëve të ri, pranimin e ankesave dhe kërkesave të konsumatorëve deri tek aktiviteti i arkave. Tabela më poshtë paraqet aktivitetin administrative të Njësive operative:

Tabela 2. Aktivitetet administrative sipas Njësive Operative.

	Konsumatorë të ri	Kërkesa	Ankesa
Lipjan	53	98	19
Shtime	50	76	11
F.Kosovë	882	551	151
Podujevë	44	177	0
Drenas	35	71	119
Obiliq	38	20	10
Graqanicë	8	14	147
TOTAL	1,110	1,007	457

Në total, në nivel të Njësive, në muajin janar janë regjistruar 1,110 konsumatorë si dhe janë paraqitur 1,007 kërkesa dhe 457 ankesa të konsumatorëve.

Aktivitetet teknike sipas Njësive Operative

Aktivitet teknike përfshinë punën e punëtorëve të ekipeve teknike që ndërlidhet me mirëmbajtjen e rrjetit të ujësjellësit, kanalizimit si dhe ujëmatësit e konsumatorëve. Aktiviteti i prodhimit nuk është i përfshirë në raportin e Njësive pasi që i njëjti është i elaboruar nga departmenti i prodhimit. Tabela më poshtë paraqet aktivitetin teknik të Njësive operative:

Tabela 3. Aktivitetet teknike sipas Njësive Operative

	Ndërrim i ujëmatësave demtuar	Vendosja e ujëmatësave kons. 0m3	Intervenime ujësjelles	Intervenime Kanalizimin
--	-------------------------------	----------------------------------	------------------------	-------------------------

Lipjan	3	3	95	161
Shtime	16	0	25	36
F.Kosovë	81	0	NA	NA
Podujevë	30	0	107	177
Drenas	40	33	104	71
Obiliq	16	5	79	NA
Graçanicë	3	0	106	NA
Total	189	41	516	445

*Sqarim, tek rubrikat e shënuara si “NA” mirëmbajtja e rrjetit bëhet nga qendra Prishtinë.

Në total, janë vendosur 230 ujëmatës gjatë periudhës TM4 2022 nëpër Njësi Operative, ku 189 prej tyre janë ndërrime të ujëmatësve të dëmtuar kurse 41 ujëmatës të tjerë janë vendosur tek konsumatorët të cilët janë faturuar me tarifë fikse (pa ujëmatës/ujëmatës i dëmtuar). Numri i intervenimeve në rrjet në total ka qenë 961, ku 516 prej tyre kanë qenë në rrjet të ujësjellësit dhe 445 prej tyre në rrjet të kanalizimit.

Sfidat

Sfida kryesore në Njësi vazhdon të jetë numri i ulët i punëtorëve. Punëtorët të cilët janë pensionuar, vdekur apo larguar nga puna ende nuk i kemi zëvendësuar/plotësuar dhe aktualisht jemi duke operuar me mungesa të konsiderushme të stafit në të gjitha operacionet e Njësive operative.

7. DRAFT- Pasqyrat Financiare për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2022

Këto pasqyra janë ende Drafti fillestar dhe pritet të pësojnë ndryshime materiale deri në finalizimin e tyre të cilat edhe auditohen . Nadaj për këtë ju lutem referojuni pasqyrave vjetore të cilat do të jenë finale

7.1 DRAFT- PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR

	Shënime	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2021
PASURITË			RISHIKUAR	PA RISHIKUAR
Pasuritë afatgjata				
Prona, ndërtesa dhe paisjet	4	78,810,470	82,044,688	99,830,497
Pasuritë e paprekshme	5	529,365	499,838	483,291
Gjithsej pasuritë afatgjata		79,339,835	82,544,526	100,313,788
Pasuritë afatshkurtëra				
Stoqet	6	1,508,500	1,576,748	1,576,748
Parapagime dhe të arkëtueshme tjera	7	176,269	225,367	225,367
Të arkëtueshme tregtare dhe të tjera	7	14,112,816	13,493,844	19,506,036
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	8	2,833,997	3,200,766	3,200,766
Gjithsej pasuritë afatshkurtëra		18,631,582	18,496,725	24,508,917

GJITHSEJ PASURITË		97,971,418	101,041,251	124,822,705
DETYRIMET DHE EKUITETI				
Kapitali bazë		25,000	25,000	25,000
Fitimet e mbajtura		(15,615,642)	(15,156,639)	(11,788,225)
Fitimi I vitit		1,646,508	(341,558)	(1,152,026)
Rezerva e rivlerësimit në korporatizim		72,260,383	72,260,383	72,260,383
Rezerva e rivlerësimit		552,622	552,622	21,776,130
Gjithsej ekuiteti		58,868,871	57,339,808	81,121,261
Detyrimet				
Detyrimet afatgjata				
Detyrimet për kredi afatgjatë	12	9,154,808	8,835,000	8,835,000
Detyrimet për të hyrat e shtyera	13	28,229,532	28,988,034	28,988,034
Gjithsej detyrimet afatgjata		37,384,340	37,823,034	37,823,034
Detyrimet afatshkurtëra				
Detyrimet për kredi afatshkurtër	12	38,867	2,460,867	2,460,867
Të pagueshme tregtare dhe të tjera	10	771,906	2,730,211	2,730,211
Detyrimet tjera	11	907,435	687,332	687,332
Gjithsej detyrimet afatshkurtëra		1,718,207	5,878,409	5,878,409
Gjithsej detyrimet		39,102,547	43,701,443	43,701,443
GJITHSEJ DETYRIMET DHE EKUITETI		97,971,418	101,041,251	124,822,705

7.2 DRAFT- PASQYRA E TË ARDHURAVE GJITHËPËRFSHIRËSE

Shënimet	Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2022	Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2021 RISHIKUAR	Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2021 PA RISHIKUAR
Shitjet	14	15,447,625	14,397,126
Kosto e mallit të shitur	15	(1,062,372)	(975,167)
Fitimi bruto		14,385,253	13,421,959
Shpenzimet e personelit	16	(5,680,746)	(5,552,179)
Shpenzime operative	17	(3,055,889)	(3,629,328)
Zhvlerësim dhe Amortizim	4,5	(3,821,117)	(6,759,831)
Shpenzime të përgjithshme administrative	17	(1,883,968)	(547,401)
Total shpenzimet		(14,441,720)	(16,488,739)
Të hyra tjera total	18	1,906,930	2,190,099
Të hyra tjera operative		620,049	222,456
Të hyrat nga interesi		-	14,568
Të hyrat nga grantet		1,286,882	1,953,075
Fitimi operativ		1,850,463	(876,681)
Shpenzimet financiare, net	19	(203,955)	(275,345)
Fitimi para tatimit		1,646,508	(341,558)
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse		-	-
Gjithsej të ardhurat gjithëpërfshirëse për vitin		1,646,508	(1,152,026)

7.3 DRAFT- PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË EKUITET

	Kapitali bazë	Fitimet e mbajtura	Fitimi i vitit	Rezerva e rivlerësimit	Rezerva e rivlerësimit në korporatizim	Gjithsej
Gjendja më 1 janar 2021	25,000	(9,940,053)	-	21,776,130	72,260,383	84,121,459
Fitimi neto për vitin	-	-	(1,152,026)	-	-	(1,152,026)
Transfer/ Ripasqyrim	-	(1,848,172)	-	-	-	(1,848,172)
Gjendja më 31 dhjetor 2021_PA RISHIKUAR	25,000	(11,788,225)	(1,152,026)	21,776,130	72,260,383	81,121,261
Fitimi neto për vitin	-	-	(341,558)	-	-	(341,558)
Transfer/ Ripasqyrim	-	(5,216,586)	-	(21,223,507)	-	(26,440,093)
Gjendja më 31 dhjetor 2021_RISHIKUAR	25,000	(15,156,639)	(341,558)	552,622	72,260,383	57,339,808
Fitimi neto për vitin	-	-	1,646,508	-	-	1,646,508
Transfer/ Ripasqyrim	-	(117,445)	-	-	-	(117,445)
Gjendja më 31 dhjetor 2022	25,000	(15,615,642)	1,646,508	552,622	72,260,383	58,868,871

7.4 DRAFT- PASQYRA E RRJEDHËS SË PARASË

Shënimet	Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2022	Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2021 RISHIKUAR	Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2021 PA RISHIKUAR
Fitimi për vitin para tatimit mbi të ardhurat	1,646,508	(341,558)	(1,152,026)
Rregullime për:			
Humbjet paraprake	-	(515,062)	-
Zhvlerësim dhe amortizim	3,821,117	3,821,117	6,759,831
Shpenzimet e interesit	203,955	275,345	275,345
Fitimi operativ para ndryshimeve të kapitalit punues	5,671,580	3,239,842	5,883,150
Ndryshimet në kapitalin punues			
(Rritja)/Zvogëlimi në stoqe	6	68,247	(79,561)
(Rritja)/(Zvogëlimi) në të arkëtueshmet tregtare dhe të tjera	7	(569,873)	4,740,615
Rritja/(Zvogëlimi) në të pagueshme tregtare dhe të tjera	11	(1,738,202)	1,246,168
Modifikime nga fitimi I mbajtur		(117,445)	(26,440,093)
Fitimi operativ pas ndryshimeve në kapitalin punues		3,314,307	(17,293,029)
			3,930,357
Tatimi në fitim i paguar	-	-	-
Paraja neto e gjeneruar nga aktivitetet operative	3,314,307	(17,293,029)	3,930,357
AKTIVITETET INVESTUESE			
Blerja e pronave dhe pajisjeve	4,5	(616,426)	(7,483,532)
Të hyrat nga shitja e pasurive fikse		-	26,951,710
Paraja neto e përdorur në aktivitetet Investuese		(616,426)	19,468,177
AKTIVITETET FINANCUERE			
Te hyrat nga huamarrja		319,808	-
Të hyrat e shtyera		(758,502)	(968,774)
Pagesat e kredisë		(2,422,000)	(2,422,000)
Interesi i paguar		(203,955)	(275,345)
Paraja neto e gjeneruar nga aktivitetet financuese		(3,064,650)	(3,666,119)
Neto rritja e parasë dhe ekuivalentëve të saj gjatë vitit		(366,769)	(1,490,971)
Paraja dhe ekuivalentët e parasë, në fillim të vitit		3,200,766	4,691,738
Paraja dhe ekuivalentët e parasë, në fund të vitit		2,833,997	3,200,767

8. Skema organizative e aprovuar në bordin e drejtorëve – 2021

